



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 14 shkurt 2020, në mbledhjen e parë (1) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 52 dhe filloi në orën 10.00

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Osman Kurtolli, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Besfort Kruma, toger, përfaqësues i FSK-së; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; znj. Albina Avdiu, kryesuese e komitetit për Komunitete; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it, z. Bekim Karaxhija – OSBE si dhe z. Xhavit Fejza dhe Florent Salihu- UNMIK.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, përshëndetje të gjithëve, mirë se keni ardhë. Është mbledhja e parë në 2020, urojmë një vit të mbarë në çdo aspekt, veçanërisht në çështjen e sigurisë publike. Fillimisht përfaqësuesit të ri të FSK-së i urojmë mirëseardhje në Këshill dhe punë të mbarë.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 02 dhjetor 2020

U miratua njëzëri

2. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit Policor z. Bekim Zogiani.

z. Bekim Zogiani, theksoi, gjendja e sigurisë në Komunë vlerësohet e qetë dhe stabile, nuk ka indikacione për prishje të rendit dhe qetësisë në përmasa të mëdha. Vitin 2019 e

kemi përmbyllë me sukses, me të cilat jeni të njoftuar gjatë prezantimit të raportit vjetor të punës, e kemi mbyllur sipas planifikimeve të punës, me minus 4% raste të përgjithshme të raportuara. Prej 1102 raste sa kanë qenë në vitin 2018, 1054 raste kanë qenë në vitin 2019. Më e rëndësishmja prej këtyre të gjitha veprave penale, veprat penale kundër pasurisë që ka qenë një shqetësim i yni dhe i gjithë Komunës kanë pas një rënie prej minus 13 %, përkatësisht nga 527 ka rënie në 454 raste të përgjithshme. Sipas evidencës të rastet e vjedhjeve ka një rënie prej minus 16%, përkatësisht nga 155 ka rënë në 130. Rastet e vjedhjeve të rënda prej 233 ka rënie në 163 raste, pra kemi një rënie prej 30%. Në trafik për shkak të numrit të aksidenteve ka ngritje në 35% në shqiptimin e gjobave krahasuar me vitin 2018 edhe pse pothuajse numri i aksidenteve nuk ka treguar ndonjë dallim me vitin 2018. Vitin 2020 e kemi filluar mirë, çështje e cila na ka ndihmuar shumë është përfundimi i projektit të instalimit të kamerave në qytet të cilat veç kanë filluar të japin rezultatet e para dhe shpresoj se edhe në fazën e dytë të zgjerimit të rrjetit jashtë qytetit do të jetë një sukses, parandalim dhe siguri më e madhe në Komunë.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, falënderojmë Komandantin e Policisë për raportin. Unë mora pjesë në prezantimin e raportit vjetor të punës së Stacionit të Policisë në Podujevë. Sipas raportit ka shumë aktivitete të Policisë të cilat domosdoshmërisht kanë prodhuar një rezultat të uljes së veprave penale, megjithatë mbetet ende shqetësuese numri i veprave në trafik. Para dy ditësh kemi pasur për vizitë Ministrin e Ministrisë së Infrastrukturës z. Lumir Abdixhiku dhe Ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Administratës Publike z. Agim Veliu, ku kemi dalur në rrugën magjistrale Podujevë-Prishtinë dhe premtimet e Ministrit të Infrastrukturës janë që kjo rrugë të përfundoj sa më shpejtë që është e mundur dhe kjo do të na ndihmojë shumë në këtë aspekt, sepse kjo po cilësohet si e rrezikshme, pikë e zezë për shkak të zvarritjes së punimeve dhe mosvendosjes së shenjave. Sikurse jeni në dijeni Ministria e Infrastrukturës ka vendosur shenjat pasi që një person ka humbur jetën duke ardhur nga jashtë. Ministri premtoi se asnjë projekt i ri në infrastrukturë në nivel vendi nuk do të iniciohet dhe zhvillohet para se të përfundojë rruga nacionale Podujevë Prishtinë deri ku është paraparë dhe pa fillimin e punimeve në ndërtimin e autostradës Besi – Merdarë, e cila drejtë persëdrejti do të ndikonte në uljen e aksidenteve. Pra është lajm i mirë se do të ketë investime në rrugë.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi se kohën e fundit kemi vërejtur se ka një aktivitet apo lëvizje të shtuar të emigrantëve në territorin e Komunës së Podujevës. Kjo është vërejtur afër pikës së kalimit kufitar me Serbinë. Ka dyshim se emigrantët po transportohen nëpër pikën kufitare nga taksistë të ndryshëm. Këta taksistë janë edhe prej komunave tjera. Për momentin ky aktivitet i emigrantëve nuk shkakton ndonjë rrezik, por nëse vazhdon atëherë mund të shkaktoj rrezik të gjendja e sigurisë. Paratë që merren nga transportimi ilegal i emigrantëve janë para ilegale dhe në një farë mënyre nga kjo krijohen edhe grupe të ndryshme kriminale dhe Komuna e Podujevës mund të preket nga këto grupe. Lëvizjet e emigrantëve duket se janë duke u zhvilluar në mënyrë të organizuar dhe nëse kjo dukuri rritet atëherë mund të shkaktoj edhe probleme në çështjen e sigurisë. Pyetja është si e shihni ju këtë situatë dhe cilët janë hapat që planifikoni t'i ndërmerri.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, për çështjen e cekur nga përfaqësuesi i KFOR-it besoj se janë të informuara institucionet përkatëse qendrore të cilat janë duke i përcjellur këto lëvizje, sigurisht edhe Policia jonë kufitare por edhe institucionet tjera janë në përcjelle të këtij fenomeni. Ne i bashkëndiejmë të gjithë ata persona dhe familje të ikur nga lufta dhe situatat e konflikteve, megjithatë çdo kalim ilegal i kufirit paraqet vepër penale. Besoj se institucionet tona përgjegjëse kanë informacione dhe do të na informojnë drejtëpersëdrejti, sepse kjo nuk është kompetencë komunale, megjithatë çdo

informacion që e kemi është mirë ta diskutojmë bashkë dhe organet tona të kenë informacione të sakta dhe me kohë dhe të marrin veprime ligjore.

z. Besfort Kruma, është hera e parë të përfaqësoj FSK-në në Komunën e Podujevës. Ne jemi të përfaqësuar në KKSB në komuna të ndryshme dhe është mirë se mund ti ballafaqojmë problemet e komunave të cilat pak a shumë janë të njëjta por secila i ka specifikat e saj. Theksoi, dy mjete eksplozivivi janë gjetur në fshtrat Orllan dhe Dumnicë gjatë muajit janar 2020. Nënvizoi kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Policinë e Kosovës. Çështje tjetër, në kuadër të aktiviteteve, gjatë kohës së reshjeve gjatë dimrit ekipet tona të deminimit e kanë më të vështirë punën në terren dhe ata pjesëtarë mund ti shfrytëzojmë për kampanja të ndryshme të informimit dhe ato ekipe kanë qenë nëpërkollat e Komunës së Podujevës dhe pjesë tjera të Kosovës për informim të të rinjve për mjetet eksplozive. Tani për tani nuk ka ndonjë aktivitet fushor por siç e dini Komuna e Podujevës na ofron një territor të volitshëm për disa ushtrime kështu që jemi në kontakt të vazhdueshëm me Komunën por edhe me Policinë. Ne si ekip, si njësi e re në FSK-së jemi kompani për operacione me civil, bashkëpunojmë me Policinë dhe kemi organizuar disa trajnime të përbashkëta me gjithë akterët në kuadër të Komunës.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, falënderojmë togerin për informatat e paraqitura. Ashtu siç e kemi bashkëpunimin me Stacionin e Policisë, bashkëpunim shumë të mirë kemi edhe me FSK-në. Më vjen mirë që tani gjeneratat e reja po i marrin këto përgjegjësi. E hap debatin rreth kësaj pike.

z. Bekim Zogiani, sa për sqarim, për atë që theksoi përfaqësuesi i KFOR-it, ju njoftoj se ka lëvizje të qytetarëve, shtetas të huaj, por është një procedurë e cila respektohet prej policisë dhe institucioneve kompetente që secili person që kërkon azil në Kosovë në bazë të Ligjit përkatës për azil duhet të plotësoj një formular, të evidentohet, mirëpo nuk e kanë të kufizuar që të qëndrojnë vetëm në qendrën e azilit, pra ata mund lirshëm të dalin dhe të qarkullojnë ditën brenda një periudhe të caktuar kohore dhe në momentin që i ndalojmë në bazë të thirrjeve, bëjmë verifikimin, nëse e ka të plotësuar formularin atëherë nuk kemi fare obligim ta marrim dhe ta kthejmë në qendër të azilit por nëse nuk kanë evidenca i trajtojmë përmes policisë kufitare, policisë së migrimit.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, meqë nuk ka të të tjerë të interesuar rreth kësaj teme kalojmë në pikën e radhës.

3.Miratimi i propozimit të Planit të punës të KKSB-së për vitin 2020 **Informatë për aktivitetet KKSB-së në vitin 2019**

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka kryesusi i grupit punues për përgatitjen e materialeve z. Faik Muçiqi.

z. Faik Muçiqi, i informoi të pranishmit për përmbajtjen e dokumenteve. Theksoi **Informata** përmban të dhënat më kryesore të punëve dhe aktiviteteve të Këshillit për vitin 2019, të nxjerra nga procesverbalet e mbledhjeve të KKSB-së.

Konstatim:

Informata për punët dhe aktivitete e KKSB-së për vitin 2019 u kalua pa vërejtje dhe e njëjta procedohet në Kuvendin e komunës.

Drejtori në vazhdim në detaje foli për temat e propozuara në draft dokumentin e Planit të Punës. Theksoi , drafti nuk përfshinë ndonjë temë e cila nuk mund të realizohet me të cilat përballemi ne si Komunë, pra nuk ka tema të cilat nuk përfshihen në kuadër të fushëveprimit të KKSB-së. Në takimet me disa komuna kemi vërejtur se ato në kuadër të

planit të punës kanë përfshi edhe tema që i takojnë dhe janë në kompetencë të Drejtorive dhe nuk përkojnë me natyrën e punës së KKSB-së. Këtë dokument mund ta pasurojmë edhe me tema tjera nëse e shihni të arsyeshme

z. Nexhmi Rudari Nënkryetar i Komunës, plani edhe pse në dukje duket ambicioz në vazhdimisht kemi arritur në fund të vitit t'i përmbyllim të gjitha aktivitetet. Besoj me një angazhim të përbashkët të të gjithë neve dhe të institucioneve që janë bartës të këtyre aktiviteteve ky plan do të realizohet, megjithatë ekziston mundësia e përfshirjes edhe të ndonjë aktiviteti që medoni se është i nevojshëm të parashihet.

znj. Donjeta Sheqiri, theksoi, aktiviteti me nr. rendor 14 të Propozim planit të punës mendoj të plotësohet dhe atë; Informatë për dukuritë negative dhe masat sensibilizuese kundër këtyre dukurive (përdorimi i narkotikëve, vjedhjet, dhuna etj.), fjala vjen të zhvillohen kampanja të ndryshme vetëdijësuese.

z. Nexhmi Rudari Nënkryetar i Komunës, pajtoj me parafolësen dhe besoj se është mirë që për secilin aktivitet me pas mundësi nxjerrjen e indikatorëve se sa një aktivitet i yni ka ndikuar në përmirësimin e gjendjes, e që kjo është edhe synim.

Gjithashtu desha të shtoj edhe diçka rreth pikës së shtruar nga z. Faik Muçiqi dhe Komandanti i Stacionit të Policisë – vendosja apo instalimi i kamerave në qytet, projekt të cilin qytetarët e kanë mirëpritur sepse janë duke treguar efektin. Sa i përket çështjes së trafikut, gjatë këtij viti fatkeqësisht ende do të jetë e mbingarkuar gjatë periudhës kur do të arrijnë bashkëatdhetarët nga vendet perëndimore, sepse rruga nacionale nuk është e përfunduar, e ku si pengësë më e madhe parashihet të jetë ndërtimi i i urës mbi lumin Llap, sepse nga ingjinerët e Ministrisë është vlerësuar se nuk mund ti shtohet urës aktuale një jesë por duhet të ndërtohet tërësisht e re për katër korësi. Ne si Komunë duhet t'i propozojmë Ministrisë së Infrastrukturës për shqyrtimin e mundësive për shfrytëzimin e rrugëve alternative, nëpër fshtrat Sfeçël, Dumosh, Batllavë., për shkak të punimeve që do të bëhen në rrugën nacionale, ose në kohën kur do të filloj ndërtimi urës për krijimin e një rruge tjetër alternative mbi lum, deri në përfundimin e urës. Për këtë do të ulemi edhe njëherë edhe me institucionet tona përkatëse për të gjetur zgjidhjen më të mirë të munshme bashkë me Ministrinë e Infrastrukturës.

Konstatim:

Propozimi i Planit të punës së KKSB-së për vitin 2020, përfshirë propozimin e dhenë nga znj. Donjeta Sheqiri, pas votimit njëzëri rekomandohet për miratim në Kuvendin e komunës.

4. Të ndryshme

z. Osman Kurtolli, theksoi, nga sot nuk do të jem pjesë e këtij këshilli. Është zgjedhur kryetari i ri i i KBI i cili edhe do të përfaqësoj KBI-në dhe për këtë do të njoftoheni edhe në formë të shkruar. Përfaqësuesit të ri i dëshiroj punë të mbarë dhe suksese. Konsideroj se KKSB gjatë kësaj periudhe sa isha ka dhenë efekte pozitive në punë dhe aktivitete. Gjithashtu falënderoj të gjitha institucionet për bashkëpunimin në nivel në fushën e sigurisë publike.

z. Nexhmi Rudari Nënkryetar i Komunës, në emër të pranishmëve falënderoj përfaqësuesin e dritashëm të KBI për kontributin dhe përkushtimin në kuadër të KKSB por edhe jashtë këtij Këshilli dhe njëherit i urojë suksese në punët dhe aktivitete e tij në të ardhmen. Mesazhi i këtij Këshilli përmes juve është përcjellur te xhemati në situata të ndryshme..

Publikisht shfrytëzoj rastin të falënderoj edhe institucionin e Bashkësisë Islame në Podujevë me të cilin kemi pas një bashkëpunim të shkëlqyeshëm përmes përfaqësueseve të saj dhe ky bashkëpunim do të vazhdojë në të ardhmen.

z. Qefser Behrami, po flas nga pozita e përfaqësuesit të KLSB-së, fillimisht dua të përsërisht Poicinë e Kosovës për punën dhe angazhimet në fushën e sigurisë publike. Megjithatë mendojse se në shumë raste ka nevojë për shtimin e masave të sigurisë. Shkolla e fshatit Kërpimëh, e kam përsëritur edhe më parë, ndoshta shumë më mirë do të ishte të rinovohet dhe do t'i plotësonte kushtet më mirë në raport me shkollën e re. Ka pas raste që plafoni i shkollës se re ka ra. Era e fortë që ishte ditë më parë ka heq dritare nga vendi. Kërkesa është bërë për rinovimin e atyre dritareve. Në objektin e shkollës së vjetër sipas burimeve të informatave nga banorët e fshatit janë duke ndodhur disa gjëra jo të mira nga persona të pa identifikuar të cilët janë përcjellur edhe përmes kamerës, për këtë është informuar edhe policia. Gjithashtu ka nevojë edhe për rregullimin e rrethojës së shkollës, kanë rënë 15 shtylla, ku në atë pjesë po hyjnë edhe qentë endacak. Kështu që për këto që i shtrova duhet ndërmarrë veprime në të ardhmen.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, theksoi, besoj se edhe Drejtori i Drejtorisë së Arsimit mban shënime për ato çështje që i takojnë. Për objektin e vjetër të shkollës duhet shikuar se çfarë mundësish kemi, se a e vlenë të rinovohet dhe të shfrytëzohet për ndonjë aktivitet, pastaj këtu shtrohet edhe çështja e mirëmbajtjes ku hynë shpenzime shtesë dhe personel shtesë.

z. Nuhi Selimi, theksoi dua të paraqes dy shqetësime nga KLSB-Orllan edhe pse është bërë dukuri se po përsëriten. Njëra kërkesë e cila është proceduar edhe në Drejtorinë përkatëse ka të bëjë për nevojën e rregullimit të trotuarit, për çka kohën e fundit edhe policia është duke bërë vërejtje, ndërsa si shqetësim tjetër është çështja e kolektorit/kanalizimit. Këtë vetëm desha ta paraqes, përndryshe kjo është çështje që i takon Drejtorisë përkatëse të Komunës.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, për çështjen e kolektorit të cekur nga parafolësi, për këtë veç se jemi duke punuar.

z. Bekim Bislimi, kam disa çështje që kanë të bëjnë drejtëpërdrejtë me sigurinë publike. Tashmë ka filluar projekti i ndërtimit të bulevardit dhe rruga “Zahir Pajaziti” veç se është mbyllur ndërsa aty kanë qenë të vendosur shenjat për tax-it e licencuar që janë duke operuar dhe të njëjtit nuk kanë ndonjë vend të caktuar, kështu që janë duke u ndalur ku po iu krijohet mundësia, ndërsa nga ana tjetër policia në këto raste ndërhyr sikurse ndaj të gjithë kundërvajtësve tjerë, sepse nuk ka shenja të trafikut të destinuara për ta. Kërkesa është që për ato kompani të transportit taxi të gjindet një hapësirë dhe të vendosen shenjat e trafikut. Gjithashtu e kemi një kërkesë që në segmentin e rrugës nga Xhamia deri te Qerdhja publike të vendoset një pengësë në kuadër të mundësive, për shkak të sigurisë së qytetarëve dhe një pengësë te rruga “Xheladin Rekaliiu.

Problem tjetër që po na paraqitet është mungesë e funksionimit të një linje telefonike në emergjencë, pastaj janë edhe ankesat për qentë endacak.

Nënkyetari përfundoi mbledhjen, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut

Mbledhja përfundoi në orën 11.15

Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani

Nr. 02-060/04-0011834/20
Podujevë, 14 shkurt 2020

Nënkryetari i Komunës
Nexhmi Rudari